

LETËR E ANGAZHIMIT

A.O. "Audit AK" shpk,
14.05.2025.

Menaxhmentit të OJQ "DURMISH ASLLANO", Prizren

Kjo letër ka për qëllim konfirmimin e kushteve në angazhimin tonë si auditorë të pavarur të OJQ "DURMISH ASLLANO" ("Organizata").

Shërbimet dhe raportet përkatëse

Ne do të auditojmë pasqyrat financiare të Organizatës për vitin që përfundon me 31.12.2024. Pas përfundimit të auditimit tonë, ne do t'ju japim një raport të auditimit për qëllime të veçanta lidhur me pasqyrën financiare të sipërpërmendur.

Përgjegjësitë dhe kufizimet e palës sonë

Objektivi i auditimit është dhënia e një opinioni mbi pasqyrat financiare nëse ato paraqesin në mënyrë të drejtë pozitën financiare dhe operacionet e Organizatës për vitin raportues. Ne kemi përgjegjësitë tona për sa i takon kryerjes së auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), në këtë rast me SNA 800/805. Këto Standarde kërkojnë që të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të dhënë sigurinë e arsyeshme nëse pasqyrat financiare kanë apo jo anomali materiale. Auditimit ynë do të përfshijë test kontrolle mbi dokumentet, evidencë mbi të cilat bazohen transaksionet e regjistruara kontabël dhe shpalosjet e pasqyrave financiare; vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga menaxhmenti sikundër edhe vlerësimin për paraqitjen e përgjithshme të pasqyrave financiare.

Pjesë e një auditimi është përfitimi i një të kuptuari të kontrolleve të brendshme, në një shkallë aq të mjaftueshme sa të lejojë të planifikojmë auditimin dhe të përcaktojmë natyrën, kohëzgjatjen, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit që do të kryhen. Auditimi nuk strukturohet në mënyrë të tillë që të japë një siguri mbi kontrollin e brendshëm ose të identifikojë rrethana të cilave duhet t'iu kushtohet vëmendje, psh. mangësitë domethënëse në strukturën ose funksionimin e kontrollit të brendshëm. Megjithatë, nëse gjatë auditimit ne vërejmë rrethana të tilla, ose nëse ne gjykojmë se ka vend për të përmirësuar praktikatat menaxheriale, këto çështje do t'ju paraqiten në një raport të veçantë.

Auditimi ynë do të organizohet në mënyrë të tillë që të përftojë një siguri të arsyeshme por jo absolute, për sa i takon zbulimit të gabimeve ose mashtrimeve të cilat mund të kenë një ndikim material mbi pasqyrat financiare, sikurse dhe zbulimit të akteve joligjore të cilat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë dhe material mbi shumat dhe saldot e paraqitura në pasqyrat financiare. Si rrjedhojë e natyrës së testeve dhe kufizimeve të tjera të vetvetishme të auditimit, së bashku me kufizimet e vetvetishme të sistemit kontabël dhe atij të kontrollit të brendshëm, ekziston një rrezik i pamënjanueshëm që përsëri disa nga gabimet ose mashtrimet materiale ose aktet e tjera joligjore të cilat kanë një efekt direkt dhe material mbi pasqyrat financiare, të mbeten të pazbuluara. Për shkak të karakteristikave të mashtrimeve, sidomos të atyre që përveç vetë aktit të mashtrimit përmbajnë edhe aktin e fshehjes së mashtrimit nëpërmjet bashkëpunimit të punonjësve me njëri-tjetrin dhe përdorimin e dokumenteve të rreme (përfshirë këtu edhe të falsifikuarat), ekzistojnë mundësitë që një auditim megjithëse i strukturuar dhe kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të mos i zbulojë mashtrimet materiale. Për më tepër, megjithëse kontrollet e brendshme zvogëlojnë mundësinë e ndodhjes dhe mbetjes së pazbuluar të gabimeve, mashtrimeve, ose akteve të tjera joligjore, ato nuk e eliminojnë plotësisht mundësinë e ndodhjes së tyre. Për këto arsye ne nuk mund të japim një siguri absolute se gabimet, mashtrimet, ose aktet e tjera joligjore, nëse ekzistojnë, do të mund të zbulohen. Megjithatë, nëse gjatë kryerjes së auditimit ne ndeshemi me një fenomen të tillë si aktet joligjore, gabimet materiale ose në ndonjë dëshmi rreth ekzistencës së mashtrimeve, kjo do t'ju behet e ditur menjëherë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit

Pasqyrat financiare të përmendura me sipër janë përgjegjësi e menaxhmentit të Organizatës. Në këtë mënyrë, menaxhmenti është përgjegjës për regjistrimin e transaksioneve në regjistrat e duhur kontabël si edhe themelimin dhe funksionim e kontroleve të brendshme në një nivel të tillë që të mundësojë përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të kontratave të financimit.

Menaxhmenti është gjithashtu përgjegjës për korrigjimin e pasqyrave financiare në mënyrë që të eliminohen anomalitë materiale dhe për të na dhënë një deklaratë me shkrim se efektet e ndonjë anomalie, e cila është lënë e pakorrigjuar gjatë angazhimit aktual, janë jomateriale, si të mara në mënyrë individuale ashtu edhe të marra së bashku me anomali të tjera për pasqyrat financiare të marra në tërësi. Menaxhmenti gjithashtu është përgjegjës që të identifikojë dhe sigurojë se Organizata vepron në përputhje me ligjet dhe rregulloret e përgjithshme dhe ato që kanë të bëjnë me aktivitetet e saj specifike.

Menaxhmenti është përgjegjës që të ve në dispozicion, brenda periudhave të arsyeshme kohore, originalet e të gjithë regjistrave kontabël dhe informacioneve të tjera të Organizatës ashtu si dhe të lejojë personelin përkatës të Organizatës të bashkëpunojë dhe t'i përgjigjet kërkesave tona specifike për informacione. Ashtu siç kërkohet prej Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ne do të kërkojmë informacione specifike prej menaxhmentit dhe punonjësve të tjerë, të tilla si informacione rreth pohimeve të pasqyrave financiare dhe efektivitetit të kontroleve të brendshme mbi raportimin financiar. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit gjithashtu kërkojnë që ne të përftojme, prej anëtarëve të caktuar të menaxhmentit, deklaratat me shkrim për sa i takon pasqyrave financiare. Përfundimet e testeve të auditimit, përgjigjet e dhëna ndaj kërkesave tona për informacione dhe deklaratat me shkrim të bëra ndaj nesh përbëjnë tërësinë e evidencave mbi të cilat ne do të mbështetemi për të formuar një opinion mbi pasqyrat financiare.

Kohëzgjatja dhe kuotat e pagesës

Pagesa për këtë auditim do të jetë, sipas marrëveshjes së mëhershme, në kuadër të pagesës së Projektit të audituar më herët gjatë vitit dhe pagesë tjetër nuk do të ketë. Ju do të njoftoheni menjëherë nëse haset ndonjë faktor ose rrethanë, e cila do të sjellë ndonjë ndryshim të rëndësishëm mbi këtë pagesë. Për sa kohë që është e mundur, ne do të përpiqemi të angazhojmë punonjësit e Organizatës Tuaj në përpilimin e listave dhe analizat e llogarive.

Kjo letër angazhimi paraqet të gjithë marrëveshjen e arritur midis nesh për sa i takon shërbimeve të ofruara nëpërmjet kësaj letre. Ajo zëvendëson të gjithë propozimet, letërkëmbimin, dhe marrëveshjet e tjera, qofshin këto në mënyrë të shkruar ose me gojë. Kjo marrëveshje do të jetë e zbatueshme për vitet e ardhshme, duke përjashtuar rastet ku përfundon afati, ndryshohet ose zëvendësohet.

Ju lutemi nënshkruajeni dhe na dërgoni kopjen që i bashkëngjitet kësaj letre për të treguar se ajo është në përputhje me kuptimin Tuaj të marrëveshjeve për auditimin e pasqyrave financiare. Ju lutemi të na njoftoni, në rast se keni ndonjë paqartësi.

Me nderime,

A.O. "Audit AK" Shpk



Përgjigja:


Kjo letër është në përputhje me kuptimin tonë të marrëveshjes.

Aprovuar nga:

OJQ "DURMISH ASLLANO", Prizren

Drejtori,

Data: 14.05.2025



LETËR E DEKLARIMEVE TË MENAXHMENTIT

nga

OJQ "DURMISH ASLLANO" Prizren

Për: A.O. "Audit AK" Shpk

Datë: 05.06.2025

Kjo letër e deklarimeve jepet në lidhje me auditimin tuaj të pasqyrave financiare të OJQ "DURMISH ASLLANO" Prizren, për vitin që përfundon me 31.12.2024, të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, rrjedha e parasë dhe ndryshimet në fonde, me qëllim të shprehjes së një opinionit nëse pasqyrat financiare janë në përputhje me dispozitat e raportimit financiar që rrjedhin nga kontratat e financimit.

Ne konfirmojmë se jemi përgjegjës për paraqitjen e vërtet të pasqyrave financiare në pajtim me dispozitat e raportimit financiar të kontratave të financimit.

Disa deklarime në këtë letër janë përkthyer si të kufizuara me ato çështje që janë materiale. Zërat konsiderohen material, nëse pavarësisht nga shuma e tyre monetare, përbëjnë një mangësi ose anomali të informatave kontabël, të tillë që, e parë në kushte normale, krijojnë mundësi që gjykimi i një personi, vendimet e të cilit mbështeten mbi këto informata, të ndryshohet ose ndikohet nga këto mangësi ose anomali.

Ne konfirmojmë, sipas njohurisë dhe besimit tonë më të mirë, deklarinet në vijim, siç ua kemi paraqitur ju gjatë auditimit tuaj:

1. Pasqyrat financiare të përmendura më sipër, paraqesin në mënyrë të vërtetë dhe të sinqertë në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Organizatës, dhe për rrjedhojë edhe rezultatet e veprimtarisë dhe rrjedhat e parasë për periudhën në fjalë në pajtim me kërkesat e raportimit financiar.
2. Ne ju kemi vënë në dispozicion të gjithë:
 - a. Regjistrat financiare dhe të dhënat përkatëse.
 - b. Procesverbalet e mbledhjeve të aksionarëve, drejtorëve dhe komiteteve drejtuese si dhe përmbledhje të diskutimeve të mbledhjeve të fundit për të cilat procesverbalet nuk janë përgatitur ende.
3. Nuk ka patur komunikime nga agjencitë rregullative lidhur me mosrespektimin e praktikave të raportimit financiar ose paraqitjen e mangësive në to.
4. Nuk ka transaksione materiale, të cilat nuk janë regjistruar siç duhet në regjistrat kontabël mbi të cilët mbështeten këto pasqyra financiare.
5. Ne besojmë se efektet e anomalive të pakorrigjuara në pasqyrat financiare të përmbledhura dhe të bashkangjitura në këtë deklaratë; dhe të përmbledhura nga ju gjatë angazhimit tuaj nuk janë materiale për pasqyrat financiare, qoftë të marra individualisht ose të marra si tërësi.
6. Llogarite e arkëtueshme të regjistruara në pasqyrat financiare paraqesin kërkesat tona valide kundrejt borxhlinjve tanë për shitjet ose ngarkesat tjera që paraqiten në datën e bilancit të gjendjes dhe janë zvogëluar në mënyrë të duhur në vlerën neto të realizueshme.
7. Stoqet e regjistruara në pasqyrat financiare janë paraqitur sipas kostos më të ulët ose vlerës neto të realizueshme, dhe janë bërë provizionet e duhura për artikujt që shiten ngadalë ose janë dalë jashtë mode ose janë të papërdorshëm janë sjellë në vlerën e tregut. Sasitë e

stoqeve në datën e bilancit të gjendjes janë përcaktuar nga numërimi fizik i stoqeve që është bërë nga punonjësit kompetent në periudha të ndryshme gjatë vitit.

8. Te gjitha detyrimet e Organizatës për të cilat jemi në dijeni janë përfshirë në pasqyrat financiare në datën e bilancit të gjendjes. Nuk ka detyrime tjera ose fitime ose humbje kontingjente që kërkohet të paraqiten si akruale ose të shpalosen, dhe nuk ka kërkesa ligjore ose vlerësime për dëme për të cilat këshillëdhënësi ynë ligjor na ka këshilluar që janë të mundshme dhe që kërkojnë të shpalosen.

9. Ne konfirmojmë se nuk ka patur:

a. Mashtrime që implikojnë menaxhmentin ose të punësuarit që kanë një rol të rëndësishëm në sistemet kontabël dhe të kontrollit të brendshëm.

b. Mashtrime që implikojnë të tjerët e që mund të kenë efekt material në pasqyrat financiare.

c. Shkelje ose shkelje të mundshme të ligjeve ose rregulloreve efekti i të cilave do të duhej të konsiderohej për tu shpalosur në pasqyrat financiar ose si bazë për regjistrimin e humbjes kontingjente.

10. Organizata nuk ka plane ose qëllime, të cilat mund të ndikojnë materialisht në vlerën bartëse ose klasifikimin e pasurive dhe detyrimeve.

11. Elementet e mëposhtëm janë regjistruar dhe shpalosur në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare:

a. Transaksionet me palët e ndërlidhura, përfshirë këtu, shitjet, blerjet, kreditë, transferet, marrëveshjet e lizingjeve dhe garancitë, dhe të arkëtueshmet dhe të pagueshmet nga palët përkatëse.

b. Garancitë, me shkrim apo orale, prej të cilave Organizata mund të ketë detyrime kontingjente.

c. Vlerësimet e rëndësishme dhe varësitë (koncentrimet) materiale për të cilat menaxhmenti ka dijeni dhe që kërkohet të shpalosen.

12. Organizata zotëron në mënyrë të kënaqshme pronësinë ndaj të gjitha pasurive të veta prej të cilave asnjëra nuk është nën hipotekë, me përdorim të kufizuar ose e lënë si kolateral.

13. Organizata ka vepruar në përputhje me të gjitha aspektet e marrëveshjeve kontraktuale, mosrespektimi i të cilave mund të ketë një efekt material mbi pasqyrat financiare.

14. Aranzhimet me institucionet financiare që involvojnë saldot që kompensohen ose aranzhime tjera që involvojnë kufizime në saldo të parasë së gatshme, linja të kredisë ose aranzhime tjera të ngjashme janë shpalosur si duhet.

15. Ne kemi shpalosur në tërësi kushtet e shitjes, përfshirë të gjitha të drejtat e kthimit ose korrigjimeve në çmim dhe të gjitha provizionet për garanci.

Sipas njohurisë dhe besimit tonë më të mirë, nuk ka ngjarje të mëvonshme të ndodhura pas datës së përfundimit të vitit raportues e deri në datën kur po lëshohet kjo deklaratë, ngjarje, të cilat do të kërkonin ndonjë ndryshim ose shpalosje në pasqyrat financiare të sipërpërmendura.

Me respekt,

OJQ "DURMISH ASLLANO" - Prizren
Fatmir Menekshe, drejtor



Përgjegjësi financiar,
Muhamet Elshani